



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VII
Sesioni vjeshtor

Kryesia e Kuvendit

P-031
Prishtinë, më 14 dhjetor 2020, në orën 12:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

IMBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 14 DHJETOR 2020

Në mbledhje morën pjesë: Vjosa Osmani-Sadriu, kryetare e Kuvendit, Arbërie Nagavci, Kujtim Shala, Memli Krasniqi dhe Fikrim Damka, nënkryetarë të Kuvendit.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetares së Kuvendit: Artan Murati.

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Sali Rexhepi, Musli Krasniqi dhe Shefki Shoshaj.

Nga: KDI-ja: Agnesa Haxhiu.

Mbledhjen e drejtoi kryetarja e Kuvendit, znj. Vjosa Osmani-Sadriu.

Kryesia, me propozimin e kryetares, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Pikat e papërfunduara nga seancat e mëparshme,
2. Përgatitjet për seancë të re plenare,
3. Shqyrtimi i propozimeve,
4. Shqyrtimi i kërkesave,
5. Të ndryshme.

* * *

1. Pikat e papërfunduara nga seancat e mëparshme

Kryesia, pas diskutimeve, vendosi që Kuvendi i Republikës së Kosovës, të premten, më 18 dhjetor 2020, në orën 9:30, të mbajë vazhdimin e seancave plenare, me këtë:

Rend dite

I. Pikat e papërfunduara nga seanca plenare, e mbajtur më 16, 21, 29 tetor dhe 27 nëntor 2020:

1. Votimi i Projektligjit nr. 07/L-025 për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim lidhur me financimin e programit - nxitja dhe levimi i mundësive për sigurimin e ujit,
2. Votimi i Projektligjit nr. 07/L-035 për ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë për likuiditet të urgjencës së infrastrukturës vitale, ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim,
3. Votimi i Projektligjit nr. 07/L-036 për ratifikimin e Kontratës Financiare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Investime për Projektin e Impiantit të Ujërave të Zeza në Gjilan,
4. Votimi në parim i Projektligjit nr. 07/L-037 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-31 për Lirinë Fetare në Kosovë,
5. Votimi në parim i Projekt Kodit Civil të Republikës së Kosovës nr. 07/L-019.

II. Pikat e papërfunduara nga seancat plenare, të mbajtura më 7, 13, 14 gusht dhe 17, 18, 21, 25, 28 shtator, 8, 16, 29 tetor dhe 27 nëntor 2020:

1. Votimi në parim i Projektligjit për mbrojtjen e vlerave të luftës së UÇK-së,
2. Votimi i propozim-rezolutës nga raportimi i Kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Avdullah Hoti, në lidhje me dialogun Kosovë-Serbi,
3. Votimi i propozim-rezolutës nga interpelanca e ministrit të Ministrisë së Punëve të Brendshme, z. Agim Veliu, sipas kërkesës së deputetes Fatmire Kollçaku, e nënshkruar edhe nga 9 deputetë tjerë nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje,

në lidhje me hyrjen dhe patrullimin e pjesëtarëve të uniformuar të Republikës së Serbisë në territorin e Republikës së Kosovës, përkatësisht në fshatin Karaçevë të Komunës së Kamenicës.

III. Pikat e papërfunduara nga seanca plenare, e mbajtur më 8, 12, 16, 29 tetor dhe 27 nëntor 2020:

1. Votimi në parim i Projektligjit nr. 07/L-018 për ndryshim plotësimin e Ligjit nr. 05/L-132 për automjete,
2. Votimi i Propozim-rezolutës nga interpelanca me kryeministrin e Republikës së Kosovës, z. Avdullah Hoti, sipas kërkesës së deputetes Besa Ismaili-Ahmeti, mbështetur edhe nga 8 deputetë të GP të PDK-së, në lidhje me përgjegjësitë në raport me zhvillimet në procesin e dialogut në Bruksel lidhur me punën e grupeve teknike.

IV. Pikat e papërfunduara nga Seanca plenare e mbajtur më 21, 29 tetor dhe 27 nëntor 2020:

1. Votimi i propozim-rezolutës nga interpelanca me kryeministrin e Republikës së Kosovës, z. Avdullah Hoti, sipas kërkesës së deputetes Fitore Pacolli-Dalipi, mbështetur edhe nga 6 deputetë të GP të LVV-së, në lidhje me pezullimin njëvjeçar i aplikimit të Republikës së Kosovës për anëtarësim në organizata ndërkombëtare,
2. Votimi i propozim-rezolutës nga interpelanca me kryeministrin e Republikës së Kosovës, z. Avdullah Hoti, sipas kërkesës së deputetes Mimoza Kusari-Lila, mbështetur edhe nga 6 deputetë të GP të LVV-së, në lidhje me përfshirjen e Republikës së Kosovës në “Zonën e mini-Shengenit ballkanik”,
3. Votimi i propozim-rezolutës nga interpelanca me kryeministrin të Republikës së Kosovës, z. Avdullah Hoti, sipas kërkesës së deputetit Rexhep Selimi, mbështetur edhe nga 6 deputetë të GP të LVV-së, në lidhje me deklarinimin dhe qëndrimin e Kryeministrit për zbatimin e Marrëveshjes për themelimin e Asociacionit të Komunave me shumicë serbe.

V. Pikat e papërfunduara nga seanca plenare, e mbajtur më 29 tetor, 2, 3 dhe 27 nëntor 2020:

1. Votimi në parim i Projektligjit nr. 07/L-021 për të drejtat pronësore të shtetaseve të huaj në Republikën e Kosovës,
2. Votimi i propozim-rezolutës nga debati parlamentar lidhur me problemet e banorëve shqiptarë në veri të Mitrovicës dhe komunave të tjera në pjesën veriore të Kosovës lidhur me pengesat që u bëhen për t’u kthyer në pronat e tyre dhe pengesat për renovimin e shtëpive të djegura gjatë luftës,
3. Votimi i propozim-rezolutës nga debati parlamentar në lidhje me vazhdimin e Qeverisë së Serbisë që të mbaj të fshehur të vërtetën për fatin e mbi 1600 civilëve shqiptarë, të rrëmbyer nga ky shtet gjatë luftës gjenocidale në Kosovë, që ende konsiderohen të zhdukur.

VI. Pika e papërfunduar nga seanca plenare, e mbajtur më 13 dhe 27 nëntor 2020:

1. Votimi i propozim-rezolutës nga interpelanca me kryeministrin e Republikës së Kosovë, z. Avdullah Hoti, sipas kërkesës së 8 deputetëve të GP të LVV-së, në lidhje me shfuqizimin e Task-forcës antikorruption në Policinë e Kosovës.

VII. Pikat e papërfunduar nga seanca plenare, e mbajtur më 12, 19, 23 dhe 27 nëntor 2020:

1. Votimi i propozim-rezolutës nga interpelanca me kryeministrin e Republikës së Kosovë, z. Avdullah Hoti, sipas kërkesës së deputetes Saranda Bogujevci, mbështetur edhe nga 6 deputetë të GP të LVV-së, për çështjen “Trajtimi i dëmshëm i temës së të pagjeturve në zotimet e 4 shtatorit, duke e kushtëzuar me personat e zhvendosur”,
2. Votimi në parim i Projektligjit nr. 07/L-033 për të drejtën ndërkombëtare private,
3. Votimi në parim i Projektligjit nr. 07/L-027 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-008 për Këshillin Ekonomiko-Social,
4. Votimi në parim i Projektligjit nr. 07/L-028 për Inspektoratin e Punës,
5. Votimi në parim i Projektligjit nr. 07/L-038 për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara në transaksionet elektronike,
6. Votimi në parim i Projektligjit nr. 07/L-012 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-073 për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.03/L-256,
7. Shqyrtimi i raportit të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2019,
8. Votimi i raportit vjetor të Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2019,
9. Votimi i rekomandimeve të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, për raportin e auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për vitin 2019,
10. Shqyrtimi i raportit vjetor të Agjencisë së Statistikave të Kosovës për vitin 2019.

VIII. Pikat e papërfunduar nga seanca plenare, e mbajtur më 30 nëntor 2020:

1. Votimi në lexim të dytë i Projektligjit nr. 07/L-005 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 03/L048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-221, me Ligjin nr. 04/L-116, me Ligjin nr. 04/L-194, me Ligjin 05/L-063 dhe me Ligjin 05/L-007,
2. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 07/L-043 për masat për uljen e kostos së shtrirjes së rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë,
3. Shqyrtimi i Programit Kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (PKZMSA) 2020-2024,
4. Votimi i raportit vjetor të Agjencisë për Ndhmë Juridike Falas për vitin 2019,
5. Votimi i raportit vjetor të Akademisë së Drejtësisë për vitin 2019,
6. Votimi i raportit vjetor të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës për vitin 2019,
7. Votimi i raportit vjetor të Agjencisë për Informim dhe Privatësi për vitin 2019,

8. Votimi i raportit vjetor të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për vitin 2019,
9. Votimi i raportit vjetor të Komisionit të Pavarur të Mediave për vitin 2019,
10. Votimi i raportit vjetor të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2019.

IX. Pikat e papërfunduara nga seanca plenare, e mbajtur më 10 dhe 11 dhjetor 2020:

1. Votimi i propozim-rezolutës nga interpelanca me ministrin e Ekonomisë dhe Ambientit, Blerim Kuçi, sipas kërkesës së deputetes Mimoza Kusari-Lila, e nënshkruar edhe nga nëntë (9) deputetë tjerë, në lidhje me dhënien e licencave afatgjate (40 vjet) për prodhimin e energjisë elektrike ndërmarrjes “KELKOS ENERGY” sh.p.k për HC “Deçani” dhe HC “Belaja”,
2. Votimi në parim i Projektligjit nr. 07/L-046 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-015 për letërnjoftim,
3. Votimi i raportit vjetor të Zyrës së Rregullatorit për Energji, për vitin 2019,
4. Votimi i raportit vjetor të Autoritetit Rregullator të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2019,
5. Votimi i raportit vjetor të Ndërmarrjes Publike Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut për vitin 2018,
6. Votimi i raportit vjetor të Ndërmarrjes Publike Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut për vitin 2019,
7. Shqyrtimi i raportit për gjendjen e mjedisit në Kosovë 2018 - 2019,
8. Votimi i rekomandimeve nga debati parlamentar për luftimin dhe parandalimin e dhunës në familje me rastin e fushatës senzibilizuese në kuadër të 16 ditëve të aktivizimit kundër dhunës në baza gjinore, sipas kërkesës së deputeteve Vlora Limani Hajnuni dhe Lirije Kajtazi, të mbështetura nga 8 deputetë tjerë,
9. Emërimi i kryesuesit dhe anëtarëve të Komisionit të Auditimit të NP KOSTT,
10. Zgjedhja e kryesuesit të Komisionit Shqyrtues në Autoritetin Rregullator për Shërbimet e Ujit,
11. Zgjedhja e dy (2) anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës, nga radhët e komuniteteve jo shumicë.

* * *

Në lidhje me interpelancën e ministrit të Punëve të Brendshme, z. Agim Veliu, sipas kërkesës së deputetes Fatmire Kollçaku, mbështetur edhe nga 5 deputetë të tjerë, në lidhje me shmangien për të raportuar në Komisionin për Çështje të Sigurisë dhe Mbrojtjes, nga pika e lartshënuar: **VII Pikat e papërfunduara nga seanca plenare, e mbajtur më 12, 19, 23 dhe 27 nëntor 2020**, kryetarja e njoftoi Kryesinë me këshillën e përgatitur nga Administrata e Kuvendit se interpelanca konsiderohet e konsumuar, pasi ajo kishte filluar në seancën plenare të mbajtur më 27 nëntor 2020 dhe që bazuar në nenin 44, paragrafi 11 të Rregullores së Kuvendit, debati për interpelancë nuk mund të vazhdojë në seancën tjetër të Kuvendit. Diskutimi i plotë i kryetares është dhënë në transkript.

Ndërsa, nënkryetarja e Kuvendit, znj. Arbërie Nagavci, deklaroi se deputetët që e kanë kërkuar interpelancën e lartshënuar do të paraqesin kërkesë të re. Diskutimi i plotë i nënkryetares Arbërie Nagavci është dhënë në transkript.

2. Përgatitjet për seancë të re plenare

Kryesia, pas diskutimeve, vendosi që Kuvendi i Republikës së Kosovës, po ashtu të premtën, më 18 dhjetor 2020, në orën 11:00, të mbajë seancë të re plenare, me këtë:

Rend dite

1. Deklarimet jashtë rendit të ditës,
2. Pyetjet parlamentare,
3. Miratimi i procesverbaleve nga seancat e mëparshme,
4. Interpelanca me kryeministrin e Republikës së Kosovës, z. Avdullah Hoti, sipas kërkesës së deputetit Liburn Aliu, mbështetur edhe nga 6 deputetë të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje për çështjen: “Përfshirja dhe ndarja e Liqenit të Ujmanit me Serbinë në dokumentin e zotimeve të 4 shtatorit 2020”,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 07/L-029 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-089 për deminim humanitar,
6. Shqyrtimi i raportit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2019,
7. Shqyrtimi i kërkesës së Fondit të Kursimeve Personale të Kosovës për miratimin e taksave vjetore për vitin 2021,
8. Shqyrtimi i raportit vjetor të Agjencisë Kundër Korrupsionit për vitin 2019,
9. Shqyrtimi i raportit vjetor të Komisionit për Ndihmë Shtetërore për vitin 2019.

* * *

Nënkryetari i Kuvendit, z. Memli Krasniqi, e shtroi çështjen se pika e rendit të ditës e propozuar për seancë plenare - Mocioni për shkarkimin e Bordit të Drejtorëve të RTK-së, nuk i plotëson kriteret nga Rregullorja e Kuvendit për procedim në seancë plenare. Diskutimi i z. Krasniqi është dhënë në transkript.

Në lidhje me çështjen e ngritur nga z. Krasniqi, diskutuan kryetarja e Kuvendit, znj. Osmani-Sadriu dhe nënkryetarët: Memli Krasniqi, Arbërie Nagavci dhe Kujtim Shala, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas diskutimeve të lartshënuara, Kryesia e Kuvendit kërkoi nga Administrata e Kuvendit që brenda 48 orëve ta përgatisë një këshillë procedurale në lidhje me Mocionin për shkarkimin e Bordit të Drejtorëve të RTK-së, të parashtruar nga 11 (njëmbëdhjetë) deputetë të GP të LVV-së.

Kryesia konstatoi se pasi të merret këshilla nga Administrata e Kuvendit në lidhje me mocionin e lartshënuar, kjo pikë do të radhitet në rendin e ditës, nëse këshilla procedurale thotë që për çështjen në fjalë vendos Kuvendi i Kosovës në seancë plenare.

* * *

3. Shqyrtimi i propozimeve

1. Nisma legislative “Projektligji për plotësim ndryshimin e Ligjit nr. 03/L-094, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-004 për Presidentin e Republikës së Kosovës”

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me procedimin e nismës legislative të lartshënuar, nxori këtë:

P ë r f u n d i m

Kërkohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës që të paraqesë mendim lidhur me Nismën legislative: Projektligji për plotësim ndryshimin e Ligjit nr. 03/L-094, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-004 për Presidentin e Republikës së Kosovës, si dhe të përgatisë Deklaratën e ndikimit buxhetor dhe Deklaratën për përafrim me legjislacionin e BE-së të këtij projektligji në afatin prej një (1) muaji nga dita e pranimit.

2. Nisma Legislative “Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 06/L-082 për mbrojtjen e të dhënave personale”

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me procedimin e nismës legislative të lartshënuar, nxori këtë:

P ë r f u n d i m

Kërkohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës që të paraqesë mendim lidhur me Nismën legislative: Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 06/L-082 për mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe të përgatisë Deklaratën e ndikimit buxhetor dhe Deklaratën për përafrim me legjislacionin e BE-së të këtij projektligji në afatin prej një (1) muaji nga dita e pranimit.

3. Konstatimi i përbërjes së Grupit të Miqësisë ndërmjet Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe Parlamentit të Republikës Popullore të Bangladeshit

Kryesia, në lidhje me Grupin e Miqësisë të lartshënuar, nxori këtë:

P ë r f u n d i m

1. Kërkohet nga grupet parlamentare që para mbledhjes së radhës së Kryesisë së Kuvendit t'i propozojnë deputetët për anëtarë të Grupit të Miqësisë ndërmjet Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe Parlamentit të Republikës Popullore të Bangladeshit.
2. Kryetari i këtij grupi duhet të jetë nga GP i PDK-së, ndërsa nënkryetari nga GP Nisma-AKR-6+.

4. Propozimi i GP Nisma-AKR-6+ për zëvendësimin e anëtarit në delegacionin e Komisionit të Përbashkët Parlamentar për Stabilizim-Acociim BE-Kosovë

Kryesia, pasi e shqyrtoi propozimin e lartshënuar, mori këtë:

V e n d i m
për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit nr. 07-V-065, datë 9. 11. 2020

Pika (I). 13. e Vendimit nr. 07-V-065, datë 9. 11. 2020, ndryshohet dhe plotësohet, si në vijim:

“Deputeti Veton Berisha caktohet anëtar në Delegacionin e Kuvendit të Republikës së Kosovës në Komisionin e përbashkët Parlamentar për Stabilizim-Asociim BE-Kosovë, në vend të deputetit Endrit Shala, si dhe deputetja Arbëreshë Krasniqi caktohet zëvendësantare, në këtë delegacion, në vend të deputetit Veton Berisha, nga GP Nisma-AKR-“6+”.

* * *

Në lidhje me delegacionet e Kuvendit të Republikës së Kosovës në organizatat ndërkombëtare diskutuan: nënkryetari Memli Krasniqi dhe kryetarja Vjosa Osmani-Sadriu, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

* * *

Ndërsa, nënkryetari Fikrim Damka e shtroi për sqarim një rast të zëvendësimeve të deputetëve në komisione parlamentare, diskutimi i të cilit është dhënë në transkript.

* * *

4. Shqyrtimi i kërkesave

1. Kërkesa e nëpunësit të Administratës së Kuvendit, Celal Ilyas, për mbështetje financiare

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V e n d i m

Z. Celal Ilyas, nëpunës i Administratës së Kuvendit, mbështetet financiarisht në shumën prej 1 800,00 euro për trajtimin e tij shëndetësor nga një sëmundje e syve.

2. Kërkesa e Organizatës Komunale të Pensionistëve dhe Invalidëve të Punës të Prishtinës, për mbështetje financiare

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V e n d i m

Refuzohet kërkesa e Organizatës Komunale të Pensionistëve dhe Invalidëve të Punës të Prishtinës për mbështetje financiare, për arsye se kërkesa nuk i plotëson kriteret e parapara me Rregulloren nr. 05/Rr-002 për shpenzimin e buxhetit të Kuvendit nga kategoria subvencione dhe transfere, të ndryshuar dhe plotësuar më Rregulloret: nr. 05-Rr.003, datë 19.12.2016 dhe nr. 007/Rr-002/2020, datë 8. 6. 2020.

3. Kërkesa e gazetës Kult Plus për mbështetje financiare

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V e n d i m

Refuzohet kërkesa e Gazetës Kult Plus për mbështetje financiare, për arsye se kërkesa nuk i plotëson kriteret e parapara me Rregulloren nr. 05/Rr-002 për shpenzimin e buxhetit të Kuvendit nga kategoria subvencione dhe transfere, të ndryshuar dhe plotësuar më Rregulloret: nr. 05-Rr.003, datë 19. 12. 2016 dhe nr. 007/Rr-002/2020, datë 8. 6. 2020.

4. Kërkesa e Shoqatës HANDIKOS për mbështetje financiare

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V e n d i m

OJQ HANDIKOS mbështetet financiarisht në shumën prej 2 800.00 euro, për projektin “Mbështetja e mirëqenies së fëmijëve me aftësi të kufizuara gjatë pandemisë”.

5. Kërkesa e Shoqatës Drita Jonë - Vushtrri për mbështetje financiare

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V e n d i m

OJQ Shoqata Drita Jonë - Vushtrri, mbështetet financiarisht në shumën prej 4 500,00 euro për aktivitetet e realizuara nga projekti “15 Tetori - Java Ndërkombëtare e Shkopit të Bardhë”.

6. Kërkesa e OJQ-së: Klubi i Basketbollit në Karroca Trepça për mbështetje financiare

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V e n d i m

OJQ Klubi i Basketbollit në Karroca Trepça, mbështetet financiarisht në shumën prej 3 000,00 euro për projektin “Sporti i Peshkimit dhe Ambienti”.

7. Kërkesa e Kaltrina Krasniqit për mbështetje financiare

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V e n d i m

Znj. Kaltrina Krasniqi, regjisore e filmit, mbështetet financiarisht në shumën prej 4 500,00 euro, për idenë dhe suksesin e filmit “Vera ëndërron detin”.

8. Kërkesa e Qendrës për Mbrojtjen e Viktimave dhe Parandalimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore për mbështetje financiare

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V e n d i m

OJQ: Qendra për Mbrojtjen e Viktimave dhe Parandalimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore mbështetet financiarisht në shumën prej 4 500,00 euro për projektin “Mbështetje psiko-sociale për viktimat e trafikimit dhe viktimat e predispozuara fëmijë dhe të rritur”, për ofrimin e mbështetjes psiko-sociale për viktimat e trafikimit, viktimat potenciale të trafikimit dhe fëmijët në rrezik për t’u trafikuar.

9. Kërkesa e Institutit për Zhvillimin e Politikave Sociale për mbështetje financiare

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V e n d i m

OJQ Instituti për Zhvillimin e Politikave Sociale, mbështetet financiarisht në shumën prej 3 300,00 euro për projektin “Përmirësimi i njohurive të mësuara në praktikë nga trajnimi mbi dhunën në familje”.

10. Kërkesa e Qendrës Kosovare për Luftimin e Kancerit të Gjirit “Jeta/Vita” për mbështetje financiare

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V e n d i m

OJQ Qendra Kosovare për Luftimin e Kancerit të Gjirit (Jeta/Vita) mbështetet financiarisht në shumën prej 5 000,00 euro për projektin “Mbështetje me pajisje ndihmese për gratë e operuara nga kanceri i gjirit”.

11. Kërkesa e z. Emin Cakiqi për mbështetje financiare

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Z. Emin Cakiqi, nga komuna e Glllogocit, mbështetet financiarisht në shumën prej 1 000,00 euro për blerjen e terapisë për sëmundjen e syve.

5. Të ndryshme

1. Propozimi për një shtesë vjetore për nëpunësit e Administratës së Kuvendit

Kryesia, pasi e shqyrtoi propozimin e lartshënuar, me shumicë votash (3 vota për, asnjë kundër dhe 2 abstenime, vendosi që të punësuarve në Administratën e Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe stafit mbështetës politik me kontratë pune me Kuvendin, për angazhim të shtuar jashtë orarit të punës gjatë aktiviteteve të Kuvendit në pandemi, në mbështetje të trupave punues të Kuvendit: Kryesisë së Kuvendit, seancës plenare dhe komisioneve parlamentare, vendosi që për vitin 2020 t’u bëhet një kompensim.

2. *Propozim për ngritjen e pagës për vozitësin e nënkryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës*

Kryesia, pasi e shqyrtoi propozimin e lartshënuar, mori këtë:

V e n d i m

1. Paga mujore e vozitësve të nënkryetarëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës të ngrihet nga koeficienti F-5, në koeficientin D-7.
2. Ky vendim hyn në fuqi më 1 janar 2021.

* * *

Po ashtu, Kryesia me propozimin e kryetares, mori edhe këtë:

V e n d i m

për plotësimin e Vendimit nr. 05-V-082, datë 7 maj 2015, për sistemimin e stafit në Kabinetin e kryetarit të Kuvendit

1. Vendimi nr. 05-V-082, të datës 7 maj 2015, plotësohet, si në vijim:

“Stafi i Kabinetit të kryetares së Kuvendit të Republikës së Kosovës plotësohet edhe me një (1) vozitës për kryetaren e Kuvendit, me pagë mujore sipas koeficientit C-8”.

2. Ky vendim hyn në fuqi më 1 janar 2021.

Kryetarja e Kuvendit e mbylli mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit në orën 14:10 minuta.

Vjosa Osmani - SADRIU

Kryetare e Kuvendit

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale

P.S.:

Ky procesverbal nuk është miratuar për shkak të shpërndarjes së Legjislaturës VII.